



Raport Studimor

VETTINGU I GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Data e publikimit,
4 Shtator 2020



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT STUDIMOR

VETTINGU I GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

(PËR VENDIMMARRJEN DHE DINAMIKËN E VEPRIMTARISË

SË INSTITUCIONEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR)

*Konkluzionet dhe të dhënat e pasqyruara në këtë raport shtrihen në periudhën
Nëntor 2019 – Korrik 2020*

Data e publikimit, 4 Shtator 2020



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ky raport studimor u përgatit nga stafi ekzekutiv i Komitetit Shqiptar i Helsinkit (KShH). Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e KShH-së dhe ekspertëve që kanë kontribuar në hartimin e tij.

Përgatitën:

1. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KShH-së
2. Znj. Ardita Kolmarku, Koordinatore Projekti/Juriste, KShH
3. Znj. Vjosana Neziri, Financiere, KShH
4. Znj. Brixhilda Dhima, Koordinatore Projekti/Paraligjore, KShH

Rishikoi:

1. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor, Komitetin Shqiptar të Helsinkit. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit



Adresa: Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”
Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752
Tel: 04 2233671
Mob: 0694075732
E-mail: office@ahc.org.al;
Web site: www.ahc.org.al



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Përmbledhje Ekzekutive

1. Dinamika e procesit të vettingut

1.1 Të dhëna sasiore mbi dinamikën e vendimmarrjes dhe të seancave të KPK-së, për periudhën Janar – Korrik 2020

1.2 Të dhëna sasiore mbi dinamikën e vendimmarrjes dhe të seancave të KPA-së, për periudhën Janar – Korrik 2020

2. E drejta për një proces të rregullt ligjor në vendimmarrjen e organeve të vettingut

2.1 Parimi i paanshmërisë së trupit gjykues

2.2 Parimi i barazisë së armëve juridike

2.3 Parimi i proporcionalitetit

3. Shqyrtimi i vendimeve të KPK-së për ndërprerjen/pushimin e vettingut

3.1. Bazueshmëria e dorëheqjes së depozituar nga ana e subjekteve të rivlerësimit

4. Vendimmarrja bazuar në një ose dy kritere

4.1. Kërkesat për riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera

5. Kriteri i vlerësimit të pasurisë

5.1. Të dhënat e organeve ndihmëse dhe të dhënat e siguruar nga hetimi administrativ i KPK-së

5.2. Analiza financiare dhe metodologjia e vlerësimit të pasurisë së subjekteve

5.3. Pamundësia e subjektit për të disponuar dokumente justifikuese

6. Kriteri i kontrollit të figures

6.1. Hetimi administrativ dhe niveli i transparencës në vendimmarrjet e studiuara

7. Kriteri i vlerësimit të aftësisë profesionale

8. Cilësia e arsyetimit, mendimet në pakicë apo paralele

Aneks 1

Lista e vendimeve objekt studimi



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve ose prokurorëve, ose siç njihet ndryshe, procesi i vettingut, përbën një nga masat më të rëndësishme reformuese të sistemit të drejtësisë në vendin tonë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në përmbushje të misionit të tij, e ka monitoruar këtë proces në tre vitet e para të zbatimit të tij, duke filluar që nga ngritja e institucioneve të vettingut¹, mbarëvajtja e seancave dëgjimore publike të zhvilluara me subjektet kryesisht prioritarë të këtij procesi² si dhe ka studiuar disa prej vendimeve të këtyre institucioneve, të publikuara në faqet e tyre zyrtare³.

Në fokus të monitorimit të KShH-së vijon të mbetet se si ky proces ka përmbushur pritshmëritë e qytetarëve, për nevojën e pastrimit të sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, standartet e ndjekura nga organet e vettingut për realizimin e këtij procesi (sa të unifikuara kanë qenë ato), qartësia, kuptueshmëria dhe struktura e vendimmarrjes së tyre, respektimi i disa aspekteve të së drejtës së subjekteve për proces të rregullt ligjor, etj.

Në përmbushje të misionit të tij, KShH prezanton raportin studimor të radhës, i cili pasqyron disa nga gjetjet kryesore të rezultuara nga studimi i 44 vendimeve të institucioneve të vettingut, të dhëna gjatë periudhës Nëntor 2019 – Mars 2020. Objekt i analizës në këtë raport studimor janë përkatësisht 36 vendimmarrje të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) që ka realizuar vettingun e subjekteve në shkallë të parë dhe 8 vendimmarrje të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA) që ka shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankimet e Komisionerëve Publikë ose të subjekteve, në shkallë të dytë⁴.

Procesi i vettingut, për shkak të rëndësisë dhe efekteve që synon në drejtim të pastrimit të sistemit të drejtësisë në vendin tonë, por gjithashtu edhe për shkak të specifikave dhe teknikaliteteve të tij, vijon të jetë një process shumë i rëndësishëm por dhe i vështirë dhe me ngarkesë të lartë për organet e vettingut. Vlen të përmendet në këtë drejtim volumi i punës së këtyre organeve sa i takon hetimit administrativ të thelluar dhe jo të lehtë, për të verifikuar informacione, të dhëna dhe fakte që qëndrojnë në themel të vendimmarrjes së tyre për konfirmimin ose shkarkimin nga detyra të subjekteve (gjyqtarëve/prokurorëve).

¹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Komisionerët Publikë dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit

² Anëtarët në Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, kandidatët nga gjyqësori që aplikuan apo u nonimuan për pozicionet në institucionet e reja të drejtësisë (KLGJ, KLP, KED, ILD, Prokurori/Gjykatë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të organizuar

³ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2018/04/Final_Raport-per-Monitorimin-e-vettingut_KShH_Shtator-2017-Prill-2018.pdf

<https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/03/RAPORT-STUDIMOR-P%C3%8BR-VENDIMMARRJEN-E-INSTITUCIONEVE-T%C3%8BR-RIVLER%C3%8BSIMIT-KALIMTAR-T%C3%8B-GJYQATAR%C3%8BVE-DHE-PROKUROR%C3%8BVE-VETTING.pdf>

<https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2018/11/RAPORT-studimor-Monitorimi-i-procesit-te-vettingut-te-gjyqtareve-dhe-prokuroreve-Jan17-Qer18.pdf>

⁴ Shih aneksin 1



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në tërësi, KShH vëren se KPK dhe KPA kanë treguar kujdes në strukturimin dhe arsyetimin ligjor të vendimmarrjeve të tyre. Edhe pse nuk është një kërkesë ligjore e detyrueshme, KShH vlerëson se në kuadër të transparencës më të mirë ndaj publikut, si një proces që ka interes dhe vëmendje të lartë të tij, në vendimet e këtyre organeve mund ti kushtohet një vëmendje e shtuar në vazhdimësi, pasqyrimin të aspekteve të rëndësishme që kanë të bëjnë me argumentat/shkaqet justifikuese të vendimeve të ndërmjetme përgjatë procesit (si psh për kërkesat e subjekteve mbi ekzistencën e konfliktit të interesit të anëtarëve të trupave gjykuese, kërkesat për riçelje të hetimit administrativ të një ose dy kritereve, kërkesa për të paraqitur prova të reja përgjatë procesit dhe veçanërisht kur ato paraqiten në seancë dëgjimore ose pas përfundimit të hetimit administrative).

Dhënia e motivacionit mbi arsyet e dorëheqjes së subjekteve të vettingut nuk është një kusht ligjor për asnjë subjekt. Gjith, nga studimi i vendimeve të KPK-së, janë vërejtur raste kur subjektet, me dëshirën e tyre kanë bërë të njohur arsyet e depozitimit të kërkesës për dorëheqje nga ushtrimi i funksionit, si psh për arsye shëndetësore, dëshirës për tu angazhuar në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor, për shkak të moshës për pension, etj.

Referuar kampionit të vendimeve të studiuara, KShH vëren se vendimmarrjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit po ndihmojnë në orientimin më të mirë të praktikës së vettingut, duke kontribuar në konsolidimin dhe qartësimin e çështjeve të diskutueshme, si psh sa i takon zbatimin parimit të proporcionalitetit në drejtim të vlerësimit tre kritereve, e veçanërisht atë të pasurisë dhe në ç'masë do të shtrihet barra e provës në raport me këtë parim për pasuritë që disponojnë vetë gjyqtarët/prokurorët si dhe personat e lidhur me ta.

Ashtu si në të kaluarën, edhe në kampionin e vendimeve të studiuara vërehet se në rastin e vendimeve të shkarkimeve, në disa prej tyre, KPK/KPA ka vendosur të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin bazuar në një kriter (kryesisht atë të pasurisë), duke mos përfunduar apo marrë në konsideratë hetimet mbi kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të aftësive profesionale. Këto vendimmarrje janë bazuar në nenin 4, pika 2 të ligjit nr.84/2016. Në vlerësimin e KShH-së, procesi do të ishte i plotë dhe më transparent për publikun, nëse subjektet i nënshtrohen hetimit të plotë administrative për të trija kriteret (filtrat e kontrollit) si dhe analizës/vlerësimit për secilin kriter dhe vlerësimin tërësor të tyre.

Kriteri i pasurisë vijon të jetë në mënyrë të dukshme dhe mbizotëruese kriteri që ka penalizuar subjektet e shkarkuara nga institucionet e vettingut. Në pjesën arsyetuese të vendimeve është pasqyruar gjerësisht hetimi administrativ i realizuar nga institucionet e vettingut lidhur me këtë kriter, i fokusuar në vërtetësinë e deklarimeve të realizuara nga subjektet dhe personat e lidhur, përmbushjen e detyrimeve, ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, evidentimit ose jo të fshehjes së pasurisë, konfliktit të interesit, etj. Në një numër të konsiderueshëm të vendimeve të studiuara vihet re se rezultatet e ILDKPKI-së përmbysen nga të dhënat e hetimit të thelluar administrativ të KPK-së, e cila vëren se deklarimi vjetor dhe deklarata vetting nuk janë të plotësuara saktë (sikurse pohon në raportin e saj ILDKPKI) apo edhe raste kur subjekti nuk vërteton burime të ligjshme mjaftueshëm për të justifikuar pasurinë. Gjith, ka ndonjë rast sporadik, kur hetimi administrative për kriterin e pasurisë



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

mund të ishte më i plotë dhe të dhënat e përfuara mund ti nënshtroheshin një analize më të detajuar të ekspertëve të certifikuar të fushës.

Vlen të diskutohet në vendimarrjen e KPK-së, nevoja për të elaboruar më mirë deri në çfarë mase mund të arrijnë pasaktësitë e vërejtura në kriterin e pasurisë dhe cili është kufiri apo indikatorët e ndjekur për të justifikuar ose jo gabimin material, elementë të cilët kushtëzojnë edhe vendimarrjen për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit.

Sa i takon kriterit të pasurisë, KShH vlerëson se ka nevojë për një unifikim të metodologjisë së ndjekur nga trupat gjykuese të KPK-së, për mënyrën se si realizojnë analizën financiare. Në vlerësimin tonë, pasqyrat përmbledhëse të analizës së kriterit të pasurisë (të pasqyruara jo gjithmonë në një vendim) duhet të detajohen në mënyrë sa më të plotë dhe të përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm që bëjnë të mundur kuptimin e tyre në mënyrë të pavarur nga lexuesit, pavarësisht nga analiza e bërë nga trupa e KPK-së.

Në pjesën më të madhe të vendimarrjeve në të cilat KPK ka vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, kriteri i vlerësimit të figurës nuk ka sjellë shkarkimin e subjektit nga detyra (për shkak se penalizues ka qenë kriteri i pasurisë). Vetëm në një vendim shkarkimi që i takon kësaj periudhe, ku konstatohen papërshtatshmëri figurës së subjektit, analiza e tij paraqitet e plotë. Ndërkohë që në vendimet e konfirmimit, analiza e kriterit të figurës gjen reflektim të plotë përgjatë tekstit të vettingut dhe rezulton se organet e vettingut kanë ndërmarrë një hetim të pavarur dhe të thelluar për verifikime të mëtejshme të këtij kriteri. Ekspertët që janë angazhuar në studim vlerësojnë se disa elementë të rëndësishëm që kanë rezultuar përgjatë kontrollit të figurës nga DSIK, KPK apo në një rast edhe nga KPA, duhet të ishin qartësuar qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur në vendim, në funksion të parimit të transparencës më të mirë ndaj publikut.

Në vendimet e studiuara vërehet se publiku ka vijuar të luajë një rol proaktiv gjatë procesit të vettingut, nëpërmjet denoncimit të fakteve apo rrethanave të lidhura me subjektet, pranë institucioneve të vettingut. Nga raportet e mëparshme studimore të publikuara nga KShH, është vënë re se denoncimet e qytetarëve në përgjithësi nuk kanë patur peshë të rëndësishme në vendimarrjet e institucioneve të vettingut. Megjithatë, trendi i kësaj vendimarrje vërehet se ka ndryshuar me kah disi më pozitiv, referuar kampionit të vendimeve të studiuara në këtë raport, nëse marrim si indikatorë mënyrën se si pasqyrohen denoncimet e ardhura përgjatë tekstit të vendimit, verifikimin dhe hetimin e thelluar administrativ që është bërë nga vetë institucionet e vettingut lidhur me këto denoncime, rezultatet/konkluzionet e dala prej tij dhe peshën që ato kanë patur në disa raste në vlerësimin tërësor të të trija kriterëve.

Është pozitiv fakti se denoncimet anonime janë marrë parasysh në hetimin administrativ kur nga përmbajtja e tyre është mundësuar verifikimi i mëtejshëm i të dhënave apo indicjeve të adresuara. Krahas denoncimeve të qytetarëve, ekspertët e KShH-së vërejnë se në vendimarrjet e organeve të vettingut janë marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, edhe fakte të njohura botërisht dhe të publikuara në media.

Pavarësisht se për të gjitha subjektet presupozohet se KLD dhe Prokuroria e Përgjithshme kanë administruar dhe vendosur në dispozicion të KPK-së relacionet lidhur me



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

kriterin e aftësive profesionale, pas ngritjes së KLP-së dhe KLGJ-së, vërehet se për një pjesë të këtyre subjekteve janë kërkuar relacione të mëtejshme, tashmë nga dy organet e reja ndihmëse (KLGJ/KLP) dhe për një pjesë tjetër, këto relacione nuk janë kërkuar. Gjithashtu, vlen për tu nënvizuar si një konstatim i përgjithshëm se vendimet e KPK-së, diktojnë nevojën për të pasqyruar në mënyrë më të unifikuar dhe të plotë, ndjekjen dhe vënien në zbatim të metodologjisë (dhe indikatorëve të saj) për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, të elaboruar në vendimin nr.21/2019 të Kolegjit (KPA-së). Kjo pasi në disa nga vendimet e studiuara vërehet se kriteri i aftësive profesionale është analizuar dhe elaboruar në mënyrë të përgjithshme dhe nën-indikatorë të rëndësishëm të këtij kriteri të lidhura me aftësitë organizative/drejtuese të subjekteve nuk kanë patur peshën e duhur në vendimmarrje sa i takon këtij kriteri, pavarësisht vërtetësisë së denoncimeve të bëra nga publiku dhe konstatimit të shkeljeve nga vetë trupat gjykuese të KPK-së.

Paralelisht me vendimmarrjen e organeve të vettingut, KShH ka monitoruar edhe dinamikën e procesit të vettingut duke u ndalur në mënyrë të veçantë në mbarëvajtjen e këtij procesi në periudhën Janar – Korrik 2020, e cila mbulon kohën para, gjatë dhe pas gjendjes së fatkeqsisë natyrore të krijuar për shkak të Virusit Covid 19.

Në tërësi, KShH vlerëson se pavarësisht sfidave, ngarkesës dhe volumit të lartë të veprimeve procedurale dhe hetimore (administrative) që shoqërojnë këtë proces, ritmet e procesit të vettingut, duhet të jenë më të larta, veçanërisht në shkallën e parë të vettingut që realizohet nga trupat e KPK-së. Sikurse dihet, në përbërje të KPK-së janë 12 Komisionerë, të cilët shqyrtojnë në trupa të përbërë nga 3 anëtarë, çka mundëson dhe krijimin e trupave që paralele. Ndërkohë që në përbërje të KPA-së janë 7 gjyqtarë, të cilët shqyrtojnë në trupë gjykimi të përbërë nga 5 anëtarë, çka nuk mundëson shqyrtrimin në mënyrë paralele të çështjeve.

Veprimtaria e KPK-së dhe KPA-së është kufizuar dhe një pjesë e kompetencave të tyre janë pezulluar për afro tre muaj gjatë periudhës së parë të pandemisë globale⁵, duke filluar nga java e dytë e muajit Mars dhe deri në fund të muajit Maj 2020. Gjatë kësaj periudhe, këto institucione kanë kryer ato funksione/ detyra/ njësi organizative që mund ta përmbushin në kushtet e banesës, nëpërmjet komunikimit elektronik dhe telefonik zyrtar. Duke zbritur javët që i përkasin këtyre muajve, për qëllim të përpunimit të statistikave, rezulton se në pjesën e mbetur të periudhës së 7 muajit të parë të 2020, në KPK janë zhvilluar mesatarisht 3.1 seanca në javë. Mesatarja më e ulët e numrit të seancave i përket muajit shkurt me 1.75 seanca në javë dhe mesatarja më e lartë e numrit të seancave i përket muajve Mars (2 javët e para) dhe Korrik 2020, me 4 seanca në javë. Po në këtë periudhë, në KPA janë zhvilluar mesatarisht 2.35 seanca në javë (muaji Janar shënon mesataren më të ulët të seancave me një mesatare prej 1.25 seanca në javë dhe Korriku mesataren më të lartë me një mesatare prej 4.5 seanca në javë)⁶.


⁵ Pezullimi nënkupton kryesisht pezullimin e afateve për të gjitha vendimet dhe seancat dëgjimore, seancat publike apo seancat në dhoma këshillimi, pezullimin e afatit të zbardhjes së vendimeve, etj.

⁶ Shënim – këto të dhëna janë marrë dhe përpunuar nga të dhënat e publikuara në kalendarët mujorë që i përkasin periudhës Janar – Korrik 2020, të bëra publike në faqet zyrtare të KPK-së dhe KPA-së.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Mesatarja e seancave te zhvilluara ne nje jave gjate periudhes Janar - Korrik 2020



Po gjatë kësaj periudhe, referuar njoftimeve të publikuara në ditët kalendarike të kalendarit të KPA-së, rezultojnë se janë regjistruar gjithsej 23 ankime ndaj vendimeve të dhëna nga KPK, prej të cilave 8 ankime i përkasin Komisionerëve publikë dhe 13 ankime i përkasin subjekteve të rivlerësuara në shkallë të parë.

Gjatë periudhës Janar – Korrik 2020, referuar të dhënave të publikuara në ditët kalendarike të kalendarëve të KPK-së, rezultojnë se janë shpallur publikisht në total 42 vendime ose një mesatare prej 9.3 vendimesh në muaj (duke mos llogaritur pezullimin e vendimmarrjes gjatë muajve të parë të pandemisë). Muaji me numrin më të ulët të vendimmarrjes është muaji Janar me 4 vendime dhe muaji me numrin më të lartë të vendimmarrjes është muaji Korrik me 14 vendime. Në këto të dhëna, nuk janë përfshirë vendimmarrjet e KPK-së për ndërprerjen e procesit të vettingut bazuar në aneksin G të Kushtetutës (për shkak të dorëheqjeve). Kështu, referuar të dhënave të publikuara nga vetë KPK, për periudhën Janar – Prill 2020, si rezultat i dorëheqjeve janë 11 vendime për ndërprerjen e procesit të 8 gjyqtarëve, 2 prokurorëve dhe 1 ndihmës ligjor⁷.


Gjatë periudhës Janar – Korrik 2020, referuar të dhënave të publikuara në kalendarin e KPA-së, janë shpallur publikisht ose në dhomë këshillimi, në total 19 vendime ose një mesatare prej 4.2 vendimesh në muaj. Muajit me numrin më të ulët të vendimeve janë muajt Janar – Shkurt (me një vendim secili) dhe muaji me numrin më të lartë të vendimeve është muaji Korrik me 10 vendime.

⁷ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/05/Raporti-janar-prill-2020.pdf>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Vendimmarrja e KPK dhe KPA gjate periudhes Janar - Korrik 2020



Vendimmarrja për periudhën Janar - Korrik 2020		
Muajt	KPK	KPA
Janar	5	1
Shkurt	6	1
Mars	4	3
Prill	0	0
Maj	0	0
Qershor	13	4
Korrik	14	10
Total	42	19
Mesatarja totale	9.3	4.2



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

1. Dinamika e procesit të vettingut

Nëpërmjet vendimit nr. 127, dt. 10.03.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) vendosi pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, për një periudhë 2 (dy javore). Situata e krijuar nga Covid-19, diktoi KLGJ-në të zgjaste kohëzgjatjen e pezullimit dy herë deri në dt. 22 Prill 2020. Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Ministrave miratoi Aktin normativ me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave, nr. 9, dt. 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19. Ky akt normativ i hapi rrugë rifillimit të punës në gjykata në dt. 27 Maj 2020, pra gati një muaj me vonë.

Teksa kufizimi i veprimtarisë së gjyqësorit u rregullua me vendimet e KLGJ-së dhe aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr. 9, dt. 25.03.2020, kufizimi i veprimtarisë së organeve të vettingut, gjatë periudhës së parë të pandemisë u komunikua në faqet e tyre zyrtare, me njoftime drejtuar publikut dhe medias. Ky kufizim zgjati për gati tre muaj duke filluar nga dt. 11 Mars për KPA-në dhe dt. 12 Mars për KPK-në dhe zgjati deri në dt. 3 Qershor 2020, pra për afri tre muaj. Konkretisht:

Në dt. 12 Mars 2020, KPK njofton në faqen zyrtare se në kuadër të përshkallëzimit të masave mbrojtëse nga COVID-19, është kufizuar më tej veprimtaria institucionale dhe janë dërguar punonjësit në shtëpi. Në vijim të tij thuhet se, duke filluar nga data 13 mars 2020, veprimtaria e KPK-së do të vazhdojë të kryhet në ato funksione/detyra/njësi organizative që mund ta përmbushin në kushtet e banesës, nëpërmjet komunikimit elektronik dhe telefonik zyrtar. Gjithashtu, po nga kjo datë, pezullohen afatet për të gjitha vendimet dhe seancat dëgjimore për subjektet e rivlerësimit të publikuara për tu zhvilluar, të cilat shtyhen deri në një njoftim të dytë zyrtar⁸.

Me njoftimin e dt. 11.03.2020, KPA njofton se, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID-19 në vend dhe në kuadër të masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar prej tij, kufizohet veprimtaria dhe shërbimet e KPA-së. Seancat gjyqësore publike dhe në dhomë këshillimi, që u përkasin juridiksionit të rivlerësimit dhe juridiksionit disiplinor, të publikuara për t’u zhvilluar, do të shtyhen deri në një njoftim të dytë dhe po kështu pezullohet, afati i zbardhjes së vendimeve si dhe hedhja e shortit manual pranë KPA-së, nga dt.12 mars 2020 deri në një njoftim të dytë. Veprimtaria e punës të KPA-së (njësoj si në rastin e KPK-së), do të vazhdojë të kryhet në ato funksione/detyra/njësi organizative që mund ta përmbushin në kushtet e banesës⁹.

1.1. Të dhëna sasiore mbi dinamikën e vendimmarrjes dhe të seancave të KPK-së, për periudhën Janar – Korrik 2020

Pranë KPK-së, për gati një periudhë 3 mujore që shtrihet gjatë datave 13 Mars – 3 Qershor 2020, nuk rezulton të jenë zhvilluar seanca publike (dëgjimore apo për shpallje vendimi) me

⁸ <https://kpk.al/njoftim-145/>

⁹ <http://kpa.al/event/njoftim-148/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

subjektet e vettingut. Megjithatë, KShH nuk disponon të dhëna zyrtare që përjashtojnë vijueshmërinë e hetimit administrativ dhe veprimeve të tjera procedurale të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit të vettingut pranë kësaj instance.

Dinamika e zhvillimit të seancave publike, me subjektet e vettingut pranë KPK-së, për periudhën Janar – Korrik 2020¹⁰, paraqitet si vijon:

- i. Gjatë muajit Janar 2020, janë zhvilluar pranë këtij Komisioni 15 seanca publike, prej të cilave 10 janë seanca dëgjimore dhe 5 seanca për shpallje vendimi. Këto seanca janë zhvilluar me 8 subjekte të rivlerësimit kalimtar. Për katër prej këtyre subjekteve janë zhvilluar mesatarisht nga 2 seanca (një dëgjimore dhe një për shpallje vendimi). Për këtë muaj, KPK ka zhvilluar mestarisht 2.5 seanca dëgjimore në javë.
- ii. Gjatë muajit Shkurt 2020, janë zhvilluar pranë këtij Komisioni 13 seanca publike, prej të cilave 7 janë seanca dëgjimore dhe 6 seanca për shpallje të vendimit. Këto seanca janë zhvilluar me 9 subjekte të rivlerësimit kalimtar, disa prej të cilëve janë dëgjuar edhe në muajin pararendës. Për 4 prej këtyre subjekteve janë zhvilluar 2 seanca publike (një dëgjimore dhe një për shpallje vendimi). KPK ka zhvilluar mesatarisht 1.75 seanca në javë gjatë këtij muaji.
- iii. Për periudhën 1 – 12 Mars 2020, janë zhvilluar 12 seanca publike pranë këtij Komisioni, prej të cilave 8 janë seanca dëgjimore dhe 4 seanca për shpallje vendimi. Këto seanca janë zhvilluar për 8 subjekte të vettingut. Për tre prej subjekteve janë zhvilluar dy seanca dhe për një subjekt 3 seanca publike. Mestarisht, KPK ka zhvilluar 4 seanca dëgjimore në javë për dy javët e para të këtij muaji.
- iv. Gjatë muajve Prill dhe Maj 2020 nuk janë zhvilluar seanca publike pranë këtij Komisioni.
- v. Gjatë muajit Qershor 2020, janë zhvilluar pranë këtij Komisioni 26 seanca publike, prej të cilave 13 janë seanca dëgjimore dhe 13 seanca për shpallje vendimi. Këto seanca janë zhvilluar me 16 subjekte të rivlerësimit kalimtar. Për tetë prej këtyre subjekteve janë zhvilluar mesatarisht nga 2 seanca (një dëgjimore dhe një për shpallje vendimi). Për këtë muaj, KPK ka zhvilluar mestarisht 3.25 seanca dëgjimore në javë.
- vi. Gjatë muajit Korrik 2020, janë zhvilluar pranë këtij Komisioni 30 seanca publike, prej të cilave 16 janë seanca dëgjimore dhe 14 janë seanca për shpallje vendimi. Këto seanca janë zhvilluar me 17 subjekte të rivlerësimit kalimtar (prokurorë dhe gjyqtarë kryesisht të niveleve të Apelit). Për 11 nga subjektet janë zhvilluar 2 seanca publike ndërkohë që për një subjekt janë zhvilluar 3 të tilla. Për një pjesë të tyre, ka patur seancë dëgjimore edhe gjatë muajit të kaluar. Gjatë këtij muaji, KPK ka zhvilluar mesatarisht 4 seanca dëgjimore publike në javë.

¹⁰ Referuar përpunimit të të dhënave të bëra publike në faqen zyrtare të KPK

https://kpk.al/seanca-degjimore/category/seance-degjimore/2020-06/?tribe_events_cat=seance-degjimore&tribe-bar-date=2020-06



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Gjatë periudhës Janar – Korrik 2020, rezulton se KPK ka hedhur shortin 4 herë duke nisur procedurën e rivlerësimit për këto subjekte¹¹:

- i. Në shortin e dt. 11 Maj 2020, për subjektin znj. Alma Hicka, kandidate për Gjykatën e Lartë.
- ii. Në shortin e dt. 8 Qershor 2020, për subjektin, znj. Irida Kacerja, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, njëkohësisht kandidate për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
- iii. Në shortin e dt. 15 Qershor 2020, për 118 subjekte, ndër të cilët 60 gjyqtarë dhe 58 prokurorë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore të vendosura në qytete të ndryshme të vendit.
- iv. Në shortin e dt. 16 Korrik 2020, për 4 gjyqtarë, një inspektor të komanduar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe një nëpunës përgjegjës pranë KLGJ (njësia e vlerësimit etik).

1.2. Të dhëna sasiore mbi dinamikën e vendimmarrjes dhe të seancave të KPA-së, për periudhën Janar – Korrik 2020

Dinamika e veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për periudhën Janar – Korrik 2020 , paraqitet si vijon:

- i. Gjatë muajit Janar 2020, janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore publike, 2 seanca gjyqësore në dhomë këshillimi, është shpallur një vendim në dhomë Këshillimi dhe janë regjistruar çështje që i përkasin 8 ankimeve të paraqitura (3 nga Komisionerët publikë dhe 5 nga subjektet) si dhe është hedhur shorti për caktimin e trupës gjyqësore që do të shqyrtojë këto çështje të ankimuara pranë KPA-së. Mesatarja e seancave (publike ose në dhomë këshillimi) të zhvilluara është 1.25 në javë.
- ii. Gjatë muajit Shkurt 2020, janë zhvilluar 7 seanca gjyqësore publike, 1 seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, është shpallur një vendim në seancë dhe janë regjistruar çështje që i përkasin 5 ankimeve të paraqitura (1 nga Komisionerët Publikë dhe 4 nga subjektet) si dhe është hedhur shorti për caktimin e trupës gjyqësore që do të shqyrtojë këto çështje të ankimuara pranë KPA-së. Mesatarja e seancave (publike ose në dhomë këshillimi) të zhvilluara është 1.75 në javë.
- iii. Për periudhën 1 – 13 Mars 2020, janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore publike, 2 seanca në dhomë këshillimi, janë shpallur tre vendime (një në dhomë këshillimi dhe 2 vendime janë shpallur publikisht në seancë. Mesatarja e seancave (publike ose në dhomë këshillimi) të zhvilluara në këto dy javë është 2.5 në javë.
- iv. Gjatë muajve Prill dhe Maj 2020 nuk janë zhvilluar seanca publike apo dëgjimore si dhe shpallje vendimi pranë këtij Kolegji.

¹¹ <https://kpk.al/shorti/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- v. Gjatë muajit Qershor 2020, janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore publike dhe 4 seanca në dhomë këshillimi. Gjatë këtij muaji, janë regjistruar çështje që i përkasin 4 ankimeve të paraqitura 2 nga Komisionerët Publikë dhe 2 nga subjektet e rivlerësimit si dhe janë dhënë 4 vendime, tre prej të cilave janë shpallur në dhomë këshillimi dhe një vendim në seancë publike. Mesatarja e seancave (publike ose në dhomë këshillimi) të zhvilluara është 1.75 në javë.
- vi. Gjatë muajit Korrik 2020, pranë KPA-së është shënuar numri më i lartë i seancave gjyqësore publike, përkatësisht 9 dhe numri më i lartë i seancave në dhomë këshillimi, përkatësisht 11 të tilla. Gjatë këtij muaji janë regjistruar çështjet që i përkasin 6 ankimeve, 2 të paraqitura nga Komisionerët Publikë dhe 4 nga subjektet. Gjithashtu, gjatë Korrikut shënohet numri më i lartë i vendimmarrjeve të KPA-së, 10 vendime (7 prej të cilave të shpallura në dhomë këshillimi dhe 3 në seancë publike). Mesatarja e seancave (publike ose në dhomë këshillimi) të zhvilluara është 4.5 në javë.

2. E drejta për një proces të rregullt ligjor në vendimmarrjen e organeve të vettingut

2.1 Parimi i paanshmërisë së trupit gjykues

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (Strasbourg), është nënvizuar se ka rëndësi themelore, që në një shoqëri demokratike gjykata të përcjellë besim tek qytetarët.¹² Neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (e drejta për proces të rregullt ligjor) kërkon që një gjykatë brenda juridiksionit të saj të jetë e paanshme. Paanshmëri do të thotë mungesë paragjykimi, apo anësi edhe ekzistenca e saj mund të provohet në mënyra të ndryshme. Kështu, Gjykata ka evidentuar dallimin midis **kriterit subjektiv**, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit, që bindja personale apo interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe **kriterit objektiv**, i cili kërkon të provuarit nëse ai apo ajo ofron garancitë mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm.¹³ Përsa i përket kriterit të anës subjektive, GJEDNJ ka argumentuar se: “*edhe dukja e jashtme mund të ketë një fare rëndësie*”.¹⁴

Përsa i përket 36 vendimmarrjeve të studiuara të KPK-së, vërehet se në 2 raste, anëtarët e trupit gjykues të zgjedhur me short kanë deklaruar qënien në konflikt interesi.¹⁵ Në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, është vendosur ngritja e një tjetër trupi gjykues

¹²Çështja *Padovani v. Italy*, vendimii dt. 26 shkurt 1993, Seria A nr.257-B p.20.

¹³Çështjet *Piersack v. Belgium*, vendimiidatës 1 tetor 1982, Seria A nr.53, § 30 dhe *Kyprianou v. Cyprus* [GC], nr. 73797/01, § 118-119, ECHR 2005.

¹⁴Çështjet *Castillo Algar v. Spain*, vendimiidatës 28 tetor 1998, Raporti 1998-VIII, p.31116, § 45 dhe *Morel v. France*, nr. 34130/96, § 42, ECHR 2000-VI.

¹⁵ Vendim nr. 255, dt. 07.01.2020 (subjekti A.H) dhe vendim nr. 240, dt. 24.02.2020 (subjekti T.S).



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje të anëtarit në situatë konflikti interesi. Me zëvendësim, çështja i ka kaluar anëtarit përkatës zëvendësues.

KShH ka konstatuar se institucionet e rivlerësimit i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë përgjatë tekstit të vendimeve (objekt i studimit), pasqyrimin të deklaratave të anëtarëve të trupës (të cilët kanë ngritur çështjen e konfliktit të interesit) si dhe pretendimeve ose jo të subjekteve lidhur me ekzistencën e rasteve të konfliktit të interesit. KShH ka vërejtur vendime ku është pasqyruar deklarimi i vetë subjektit të rivlerësimit për ekzistencën ose jo të kushteve të konfliktit të interesit.¹⁶ M gjith, ka patur raste sporadike të vendimeve, ku pretendimet e mundshme të subjekteve të rivlerësimit lidhur me këtë aspekt nuk gjejnë pasqyrim përgjatë tekstit të vendimit.¹⁷

Referuar nenit 27, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, Neni 27 “Çdo person, i cili ka informacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim trupin gjykues, i cili ia përcjell kërkesën për vendim një trupi tjetër gjykues, të caktuar me short”. Në këtë dispozitë nuk përcaktohet momenti procedural kur personi mund të ngrejë pretendimin për ekzistencën e konfliktit të interesit. Megjithatë, neni 4, pika 6 e ligjit të vettingut përmban një dispozitë referuese, ndër të tjerash tek ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Lidhur me konfliktin e interesit, ky ligj gjithashtu nuk ka parashikime konkrete por referuar nenit 1, pika 2 të tij, dispozitat e tij plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe. Është pikërisht neni 74 i Kodit të Procedurës Civile që përmban disa kufizime nga pikëpamja kohore se kur palët mund të ngrenë çështjen e konfliktit të interesit të gjyqtarit/gjyqtarëve. Sipas nenit 74, paragrafi i dytë, kjo kërkesë duhet të depozitohet në sekretarinë e gjykatës kur është bërë i ditur emri i gjyqtarit apo gjyqtarëve që shqyrtojnë çështjen dhe në rastin e kundërt menjëherë pas shpalljes së gjyqtarit apo gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjen. Në paragrafin e tretë të nenit 74, parashikohet se paraqitja e mëvonshme e kërkesës lejohet vetëm kur pala ka marrë dijëni më vonë për shkakun e përjashtimit ose kur gjatë ushtrimit të funksioneve, gjyqtari ka shfaqur mendim të njëanshëm e në mënyrë të papërshtatshme mbi faktet dhe rrethanat objekt gjykimi, por sidoqoftë jo më vonë se tri ditë nga marrja dijëni. **Lidhur me këtë aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, vërehet se KPK në vendimarrjen ndaj subjektit të rivlerësimit E.K., në fillimet e procesit nuk ka patur pretendime nga subjekti për ekzistencën e konfliktit të interesit, kur i është bërë me dije përbërja e trupit gjykues.¹⁸ Ndërkohë në çelje të seancës dëgjimore, bazuar në nenet 72 e vijues K.Pr.Civile, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kërkesën për përjashtimin e relatores së çështjes. KPK ka vendosur ndërprerjen e seancës me qëllim shqyrtimin e kërkesës së depozituar, nga një tjetër trup gjykues. Kjo kërkesë është rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe në prova.¹⁹**

¹⁶ Si psh, vendimet e KPK-së nr. 234, dt. 04.02.2020, vendim nr. 236, dt. 06.02.2020, vendim nr. 204, dt. 06.11.2019 etj.

¹⁷ Vendimi i KPK, i konfirmimit në detyrë të subjektit D.B nr. 229, dt. 28.01.2020

Vendimi KPK-së i shkarkimit nga detyra të subjektit M.B nr. 228, dt. 17.01.2020

¹⁸ Parag. 3, vendim nr. 233, dt. 03.02.2020

¹⁹ Parag. 14, idem.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

2.2 Parimi i barazisë së armëve juridike

Barazia e armëve juridike është një tipar i qënësishëm i procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit kërkohet që secilës palë t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e tij/saj, në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh përballë kundërshtarit të tij/saj.²⁰ Për këtë aspekt të procesit të rregullt, rëndësi të veçantë zë procesi i mbledhjes së provave, i cili ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në fatin e përfundimit të gjykimit në tërësi.

Në vendimet e KPA-së, objekt studimi, rezulton se trupat gjykuese përkatëse e kanë mbështetur analizën për pranueshmërinë për shqyrtim ose jo të provave të depozituara rishtazi nga ana e subjektit të rivlerësimit, në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Në vendimin ndaj subjektit A.B.²¹, ky i fundit, në cilësinë e provave i kishte bashkëngjitur ankimit disa akte justifikuese, të cilat Kolegji nuk i pranoi, bazuar në dispozitën e mësipërme ku thuhet se **subjekti duhet të provojë se ka qenë në pamundësi të paraqitjes së këtyre provave në fazën e hetimit administrativ.**

Krahas kësaj është vënë re se subjekteve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u është kërkuar të depozitojnë prova rishtazi gjatë hetimit administrativ me qëllim verifikimin e vërtetësisë së deklaratave të dorëzuara. Kështu në rastin e subjektit F.I, përveç provave të depozituara deri në datën 20.11.2019, subjekti ka paraqitur edhe një vërtetim nr. *** prot., datë 22.11.2019, nga shoqëria **** sh.a, ku përcaktohet paga bruto dhe tatimi i mbajtur mbi pagën për të vëllanë, për periudhën 2000 – 2013²².

2.3 Parimi i proporcionalitetit

Neni 4 i ligjit nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” parashikon se, Komisioni dhe Kolegji udhëhiqen nga parimi i proporcionalitetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe funksioneve të tyre.

Referuar kampionit të vendimeve të studiuara, KShH vëren se vendimmarrjet e Kolegjit po ndihmojnë në konsolidimin dhe qartësimin e çështjeve të diskutueshme sa i takon parimit të proporcionalitetit, për mënyrën se si po aplikohen dhe vlerësohen tre kriteret si dhe masën se deri ku do të shtrihet zbatimi i legjislacionit të vettingut në raport me subjektet dhe personat e lidhur me ta. Konkretisht:

Në bazë të vendimit 15/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite

²⁰ GJEDNJ, vendimet Öcalan v. Turkey [GC], § 140; Foucher v. France, § 34; Bulut v. Austria; Faig Mammadov v. Azerbaijan, § 19.

²¹ Vendim nr. 1, dt. 15.01.2020.

²² Vendimi nr 220 dt. 10.12.2019



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur.

3. Shqyrtimi i vendimeve të KPK-së për ndërprerjen/pushimin e vettingut

Referuar kampionit të vendimeve të përzgjedhura për studim, rezulton se në 13 raste, KPK ka vendosur ndërprerjen e procesit të vettingut ndaj subjekteve të rivlerësimit, për shkak se prej tyre janë depozituar kërkesa për dorëheqje.

3.1. Bazueshmëria e dorëheqjes së depozituar nga ana e subjekteve të rivlerësimit

Dhënia e motivacionit mbi arsyet e dorëheqjes së subjekteve të vettingut nuk është një kusht apo detyrim ligjor. Mgjth, në vazhden e vendimmarrjeve të KPK-së të shqyrtuara nga ana e ekspertëve të KShH-së, janë vërejtur raste kur subjektet, me dëshirën e tyre kanë bërë të njohur arsyet e depozitimit të kërkesës për dorëheqje nga ushtrimi i funksionit. Subjektet S.K.²³ dhe N.S.²⁴, depozituan kërkesën për dorëheqje mbështetur në arsye shëndetësore, të cilat e bëjnë të pamundur vijueshmërinë e ushtrimit të funksionit të tyre, subjekti J.Q. e mbështeti kërkesën e saj mbi motivin e angazhimit në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor,²⁵ ndërsa subjekti O.A. ka paraqitur dorëheqjen pranë KLGJ-së për shkak të mbushjes së moshës 65 vjeç.²⁶

Në shqyrtimin e kërkesave për dorëheqje të subjekteve, KPK është përballur edhe me raste jo tipike për jurisprudencën e saj, sikurse është rasti i subjektit E.K., e cila ushtronte funksionin e këshilltares ligjore pranë Gjykatës së Lartë dhe depozitoi kërkesën e saj për dorëheqje, në kohën kur ndiqte trajnimin 2 vjeçar në Shkollën e Magjistraturës. KLGJ nuk e miratoi dorëheqjen e depozituar me pretendimin se “*në kushtet kur znj. E.K. ka ndërprerë marrëdhënien juridike të punësimit si ndihmëse ligjore/këshilltare ligjore (jomagjistrate) në Gjykatën e Lartë në datën 1.10.2018, pra, përpara krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (datë 12.12.2018), si dhe kur për përfundimin e kësaj marrëdhënieje është shprehur organi publik që ka vijuar të ushtrojë kompetencat e organit të emërtesës për këtë kategori të punësuarish deri në krijimin e Këshillit, ky i fundit nuk ka detyrimin dhe as mund të shprehet për këtë çështje, tashmë ligjërisht të trajtuar/mbyllur.*”. **Lidhur me këtë çështje, KPK argumentoi në vendimin e tij se, viti i parë i shkollimit teorik dhe praktika/stazhi në vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës janë veprimtari të kryera për shkak të statusit, *ex officio* si këshilltar ligjor, që subjekti i rivlerësimit gëzonte.** Pavarësisht se KLGJ nuk u shpreh në përputhje me nenin 70/3, pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative, kjo nuk përbën rrethanë ndikuese mbi vendimin për pushimin e procesit të

²³ Vendim i KPK-së nr. 235, dt. 04.02.2020.

²⁴ Vendim i KPK-së nr. 205, dt. 06.11.2019.

²⁵ Vendim i KPK-së nr. 204, dt. 06.11.2019.

²⁶ Vendim i KPK-së nr. 246, dt. 05.03.2020.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

rivlerësimit, siç është arsyetuar edhe nga KPA në vendimin nr. 17/2019 (JR). **Si rrjedhojë, trupi gjykues ka konsideruar se për sa kohë që subjekti vazhonte të gëzonte statusin e këshilltares ligjore dhe për sa kohë procesi i rivlerësimit nuk kishte përfunduar ende, është konsideruar si tërheqje nga statusi i këshilltares ligjore, tërheqje nga detyra dhe heqje dorë nga procesi i rivlerësimit.**²⁷

4. Vendimmarrja bazuar në një ose dy kritere

Ashtu si në të kaluarën, edhe në kampionin e vendimeve të studiuara vërehet se në rastin e vendimeve të shkarkimeve, në disa prej tyre, KPK/KPA ka vendosur të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin bazuar në një kriter (kryesisht atë të pasurisë), duke mos përfunduar dhe duke mos marrë në konsideratë hetimet mbi kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të aftësive profesionale.

Në këto vendime, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ me pasurinë, trupat gjykuese kanë vlerësuar se kriteri i pasurisë është i mjaftueshëm për procesin vendimmarrës lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve përkatës. Kushtetuta e RSH dhe ligji nr.84/2016 parashikon që procesi i vettingut kërkon kontroll të të tri komponentët që qëndrojnë në themel të tij, mgjth, organet e vettingut e kanë bazuar këtë vendimmarrje në nenin 4, pika 2 të ligjit të vettingut nr.84/2016. Kjo vendimmarrje është e kuptueshme që diktohet gjithashtu nga nevoja për ritme më dinamike të këtij procesi që kryhet nga organe me mandate të kufizuar në kohë.

Në vlerësimin e KShH-së, procesi do të ishte i plotë dhe më transparent për publikun, nëse subjektet i nënshtrohen hetimit të plotë administrative për të trija filtrat e kontrollit si dhe analizës/vlerësimit të organeve të vettingut për secilin kriter dhe vlerësimin tërësor të tyre.

KPA, në vendimin 23/2019 saktëson se *‘KPK dhe KPA janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave. Në bazë të këtij parashikimi ligjor, KPK ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit, dhe pasi ka vlerësuar se e ka hetuar në mënyrë të plotë kriterin e pasurisë, bazuar në provat e grumbulluara dhe vlerën e tyre provuese, ka arritur në përfundimin se vlerësimi i subjektit të rivlerësimit mund të bëhet edhe vetëm për kriterin e pasurisë, pa qenë nevoja e përfundimit të hetimit të plotë edhe të dy kritereve të tjera’* (shih para. 21 i vendimit 23/2019 të KPA).

Në rastet kur vendimmarrja bazohet në një kriter, KShH ndan vlerësimin se terminologjia e përdorur nga KPK sa i takon konkluzioneve lidhur me mënyrën se si është realizuar hetimi administrativ, mund të ishte më e qartë. Konkretisht, në një nga vendimet, KPK referon se ka kryer *“hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të*

²⁷ Vendim i KPK-së nr. 233, dt. 03.02.2020



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*nevojshme, për procedurën e rivlerësimit*²⁸, duke krijuar përshtypjen e shtrirjes së hetimit në të treja kriteret mbi bazën e të cilave kryhet procesi i rivlerësimit.²⁹ Kjo natyrë terminologjike rezulton të jetë përdorur dhe në vendimarrjen për subjektin S.K. (citim) *“relatori i çështjes kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm”*³⁰. Në arsyetimin e kësaj vendimarrje vërehet kontradiktoritet në analizën logjike të përdorur, pasi ndërkohë që në paragrafin 9, konstatohet se trupi gjykues ka vendosur të njoftojë subjektin se ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit (duke përfshirë dhe anekset DH dhe E të Kushtetutës, të cilat i referohen kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale), në fakt subjektit i është njoftuar kalimi i barrës së provës vetëm për kriterin e pasurisë (parag.10).

4.1. Kërkesat për riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera

Nga vendimarrjet objekt studimi, rezulton se vetëm në 7 raste, subjektet e rivlerësimit kanë depozituar kërkesë për rihapjen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, figurën dhe aftësitë profesionale.³¹ Kështu, në rastin e subjektit D.M, rezulton se në datën 22.11.2019, subjekti i është drejtuar KPK-së, me objekt riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e figurës. Me vendimin nr. 3, datë 22.11.2019, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim tri kërkesat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vendosi mospranimin e tyre.³² Refuzimi i kërkesës për ricçeljen e hetimit administrativ është vënë re edhe në vendimin e subjektit B.M, për të cilin, pas analizimit të tria kriterëve, komisioni vendosi shkarkimin e saj. Ndërsa në rastin A.V³³, për shkak të evidentimit dhe administrimit të provave të reja nga Komisioni, pas mbylljes së hetimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë – trupi gjykues vendosi riçeljen kryesisht të hetimit administrativ, si dhe njoftoi subjektin lidhur me këtë vendim. Subjekti i rivlerësimit depozitoi në Komision nëpërmjet postës elektronike – kërkesë për rihapjen e hetimit dhe vlerësimin edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të figurës dhe të vlerësimit profesional, si dhe njohjen me të gjithë dokumentacionin e grumbulluar nga Komisioni edhe për këto dy kriteret. KPK, pasi shqyrtoi këtë kërkesë, vlerësoi se deri në këtë fazë të hetimit, provat e grumbulluara kanë arritur nivelin e provueshmërisë sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 52, të ligjit 84/2016 dhe vendosi: mospranimin e kërkesës, duke njoftuar subjektin e rivlerësimit për këtë vendim³⁴.

Në rastin e subjektit A.XH., KPK vendosur të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar në kriterin e pasurisë, duke e shkarkuar subjektin dhe duke bazuar ndër të tjerash vendimarrjen, në nenin nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 që parashikon se: *“Kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji”*. Nga leximi literal i këtij neni vërehet se ligjvënësi ka reflektuar qasjen kumulative nëpërmjet përdorimit të lidhëzes

²⁸ Vendim nr. 236, dt. 06.02.2020

²⁹ Neni 4, pika 1 i ligjit nr. 84/2016

³⁰ Parag. 8, i vendimit nr. 235, dt. 04.02.2020

³¹ Vendim nr. 228, dt.17.01.2020, vendim nr. 237, dt. 12.02.2020, vendimi nr.217 dt.05.12.2020, vendimi nr.206 dt. 07.11.2019, vendimi nr.210 dt.14.11.2019, vendimi nr. 214 dt. 22.11.2019, vendimi 211, date 18.11.2019

³² Parag 12-13 i vendimit nr. 217 dt. 05.12.2019

³³ Vendimi nr. 214 dt. 22.11.2019

³⁴ Parag. 17-18 vendimi nr.214 dt.22.11.2019



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

“dhe”, si rrjedhojë subjekti duhet të realizojë deklaram të pamjaftueshëm për të dy kriteret e vlerësimit, në mënyrë që masa disiplinore e dhënë në ngarkim të tij të përliqet nga aplikimi i kësaj dispozite ligjore. **Pavarësisht se Komisioni ka vendosur përfundimin e procesit të rivlerësimit vetëm bazuar në kriterin e pasurisë, rezulton se deklarimi i pamjaftueshëm lidhur me kriterin e figurës ka ndikuar në këtë vendimmarrje.**

Kërkesa e depozituar nga subjekti M.B. për të rihapur hetimin administrativ edhe për dy kriteret e tjera, rezulton të mos jetë pranuar nga trupi gjykues i KPK-së. **Në vendimmarrjen përfundimtare nuk pasqyrohet shkak/argumentat e refuzimit,³⁵ ndërkohë që provat e reja të depozituara nga ana e subjektit u administruan nga trupi gjykues.** I ndryshëm rezulton standarti reflektues në vendimmarrjen e KPK-së lidhur me përcaktimin e shkakut/argumentave të refuzimit të kërkesës për riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera, parashtruar nga subjekti A.XH. Në këtë rast, KPK I ka pasqyruar ato në vendimmarrjen përfundimtare ku thuhet se *“subjekti nuk paraqiti prova dhe dokumente shkresore për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me rezultatet e hetimit për kriterin e pasurisë, të tilla që do të bënin të domosdoshëm riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera”*.³⁶ Qëndrimi i KPK-së mbi domosdoshmërinë e paraqitjes së provave që vërtetojnë të kundërtën e indikatorit mbi të cilin trupi gjykues ka vlerësuar se ka pasur elementë të mjaftueshëm provueshmërie (në këtë rast ai pasuror), në mënyrë që rihapet hetimi administrativ për dy kriteret e tjera bazë, nuk gjen mbështetje psh në rastin analog, të subjektit M.B., i cili, edhe pse paraqiti prova të reja, kjo nuk solli pranimin e kërkesës së depozituar për riçeljen e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera. Mgjth, sikurse është evidentuar edhe në paragrafin e mësipërm, për këtë subjekt nuk është pasqyruar argumentimi i refuzimit të kërkesës në vendimmarrjen përfundimtare, ndaj dhe pikëpamjet e ekspertëve të KShH-së lidhur me këtë aspekt, janë të pjesshme.

5. Kriteri i vlerësimit të pasurisë

Vendimet e studiuara përfshijnë analizë të detajuar të vlerësimit të kriterit të pasurisë për subjektet e vettingut. Gjatë arsytimit të vendimeve është pasqyruar gjerësisht hetimi administrativ i realizuar nga organet e vettingut duke u bazuar në deklaratat vjetore të subjekteve, deklaratën vetting dhe dokumentet justifikuese që mbështesin këto deklarata. Hetimi administrativ është fokusuar në vërtetësinë e deklarimeve të realizuara nga subjektet dhe personat e lidhur, përmbushjen e detyrimeve, ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, evidentimit ose jo të fshehjes së pasurisë, konfliktit të interesit, etj.

5.1. Të dhënat e organeve ndihmëse dhe të dhënat e siguruar nga hetimi administrativ i KPK-së

Në pothuajse të gjitha vendimet e studiuara vërehet se KPK ka kryer hetim administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjekteve dhe ligjshmërisë së burimit dhe krijimit të saj, duke mos u mjaftuar me raportin e arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Psurisë dhe Konfliktit të Interesit

³⁵ Parag. 13-15 i vendimit nr. 288, dt. 17.01.2020

³⁶ Seksioni III “Seanca dëgjimore” i vendimit nr. 237, dt. 12.02.2020



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

(ILDKPKI). Në një numër të konsiderueshëm të vendimeve të studiuara vihet re se rezultatet e ILDKPKI-së përmbysen nga të dhënat e hetimit administrativ të KPK-së, e cila vëren se deklarimi vjetor dhe deklarata vetting nuk janë të plotësuara saktë sikurse pohon në raportin e saj ILDKPKI apo edhe raste kur subjekti nuk vërteton burime të ligjshme mjaftueshëm për të justifikuar pasurinë.

Mgjth, ka ndonjë rast sporadik, kur hetimi administrative për kriterin e pasurisë mund të ishte më i plotë dhe të dhënat e përfuara mund ti nënshtroheshin një analize më të detajuar të ekspertëve të fushës. Kështu, për subjektin D.M³⁷, për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare, për të vërtetuar fitimin neto të aktivitetit të K. D., si noter, KPK i është referuar dokumenteve të administruara nga ILDKPKI-ja, si dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Me qëllim që vlerësimi nga ana e komisionit të ishte më objektiv dhe i plotë, mund të ishin marrë për bazë të dhëna statistikore nga institucione të specializuara si INSTAT ose të dhënat ekzistuese të nënshtroheshin një analize nga ekspertë të fushës. Nevoja e dhënies së një opinioni nga ekspertë të çertifikuar të fushës vihet re edhe në situata të tjera, gjatë vendimmarrjes së KPK-së për vlerësimin e pasurisë.

Vlen të diskutohet në vendimmarrjen e KPK-së, nevoja për të elaboruar më mirë deri në çfarë mase mund të arrijnë pasaktësitë e vërejtura në kriterin e pasurisë dhe cili është kufiri apo indikatorët e ndjekur për të justifikuar ose jo gabimin material, elementë të cilët kushtëzojnë edhe vendimmarrjen për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit. Indikatorë të tillë referues mund të jenë të nevojshëm pasi krijojnë qartësi për nivelin e pasaktësive të evidentuara dhe vlerësimin në mënyrë më objektive të zbatimit të parimit të proporcionalitetit.

Kështu psh, në dy nga vendimet e studiuara, KPK i ka konsideruar pasaktësitë në deklaratën vetting, si pasaktësi formale (në deklaram) pa pasoja thelbësore për peshën minimale që ato mbartin në raport me tërësinë e procesit të rivlerësimit të subjektit, dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit, trupi gjykues i ka çmuar si fakt/rrethanë të pamjaftueshme për të passjellë, aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, me pasojat e parashikuara prej tij³⁸.

5.2. Analiza financiare dhe metodologjia e vlerësimit të pasurisë së subjekteve

Bazuar në përmbajtjen e vendimeve të studiuara sa i takon kriterit të pasurisë, KShH vlerëson se ka nevojë për një unifikim të metodologjisë së ndjekur nga trupat gjykuese të KPK-së, për mënyrën se si realizojnë analizën financiare. Në disa prej rasteve të konfirmimit të subjekteve në detyrë, vendimi nuk pasqyron në mënyrë të plotë, me pasqyrat përkatëse, analizën financiare³⁹. Edhe në vendimet që paraqesin pasqyrat përmbledhëse respektive pak të detajuara ose të detajuara plotësisht, mungon një rend kronologjik dhe i unifikuar i ndjekur për realizimin e analizës financiare. Mungesa e rendit kronologjik apo edhe e elementëve të caktuar përgjatë analizës financiare (në përmbajtjen e vendimit), e

³⁷ Vendimi i KPK-sw Nr: 217, dt. 05.12.2019

³⁸ Kjo e evidentuar në vendimin nr. 224 datë 20.12.2019 për subjektin e rivlerësimit A.K, vendimi nr. 207 datë 08.11.2019, etj.

³⁹ Vendimi nr. 221 datë 10.12.2019, vendimi nr. 231 datë 29.01.2020, vendimi nr. 224 datë 20.12.2019.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

bëjnë të pamundur kuptueshmërinë e kësaj analize nga lexuesi, në mënyrë të pavarur nga analiza e reflektuar nga komisioni.

Kështu psh, në vendimin nr. 224 datë 20.12.2019, ekspertët e KShH-së evidentojnë paqartësi në drejtim të metodologjisë që është ndjekur për vlerësimin e kriterit të pasurisë ndaj subjektit. Në vendim thuhet se *“Në mënyrë të detajuar sipas viteve janë konsideruar dhe përlogaritur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet në bazë të tyre është vlerësuar mjaftueshmëria e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara nga komisioni, me të ardhura nga burime të ligjshme, sipas nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës.”* Por, në përmbajtje të vendimit nuk është pasqyruar ndonjë pasqyrë përmbledhëse e analizës, nuk është evidentuar mënyra e llogaritjes së shpenzimeve, kursimeve apo normave të përdorura për llogarijen e tyre. Gjithashtu, vërehet se edhe llogaritja e shpenzimeve të jetësës në vlerësimin tonë mund të ndiqte një metodologji e unifikuar dhe qartazi të shprehur. Në vendim thuhet se *“shpenzimet jetike nga data 1.1.2010 deri më 31.3.2010, të përlogaritura në mënyrë proporcionale, sipas metodologjisë standard, kanë rezultuar në vlerën 153.697 lekë (referuar vendimit nr. 2224)”* por nuk jepen shpjegime të mëtëjshme çfarë nënkupton metodologjia standard apo te jepet ndonjë indeks i përdorur në llogaritje. Në këto kushte vlerësojmë së vendimi i publikuar nga KPK duhet të ishte më i plotë, më i qartë, i mirëorganizuar dhe i kuptueshëm, duke siguruar në këtë mënyrë, një nivel më të lartë transparencë për publikun.

4.3. Pamundësia e subjektit për të disponuar dokumente justifikuese

Gjatë studimit të vendimeve janë evidentuar raste kur subjekti i rivlerësimit e ka patur të pamundur të disponojë dokumenta që justifikojnë veprimin financiar, për shkak të marrëdhieve jo formale me familjarët me të cilët janë këto veprime janë realizuar në cash. Sjellim në vëmendje rastin e huasë në vendimin e subjektit D.M, ku huaja e marrë nga babai i bashkëshortit ishte e pamundur të identifikohet me një dokument justifikues. Subjekti referoi se veprimi financiar i kalimit të huasë ishte bërë në cash dhe për shkak të marrëdhënies familjare midis dy personave, nuk ishte formalizuar përmes një kontrate.

Në këtë rast KPK ka marrë vendim duke u bazuar në analizën financiare të huadhënësit brenda periudhës së dhënies së huasë, por duke mos e konsideruar babain e bashkëshortit si person të lidhur. Në fakt marrja në konsideratë vetëm periudhën e dhënies së huasë mendojmëse është e diskutueshme, personi në fjalë mund të konsiderohej si person i lidhur dhe të realizohej analiza financiare e plotë e pasurisë së tij. Në këtë mënyrë, mund të vërtetohej qartë nëse personi në fjalë ka patur pasuri të mjaftueshme që justifikon dhënien e huasë të birit.

6. Kriteri i kontrollit të figurës

6.1. Hetimi administrativ dhe niveli i transparencës në vendimmarrjet e studiuara



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Bazuar në nenin DH të aneksit kushtetues dhe në dispozitat e ligjit nr. 84/2016, kontrolli i figurës së gjyqtarit/prokurorit kërkon verifikimin e deklarimeve të tij/saj dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e ekzistencës ose jo të kontakteve të papërshtatshme të gjyqtarit ose prokurorit me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës duhet të bazohet në prova të sakta, në informacione konfidenciale dhe informacione të tjera të disponueshme. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) është organi ndihmës që në bashkëpunim me institucionet e rivlerësimit (në cilësinë e organeve përgjegjëse) realizon kontrollin e këtij kriteri.⁴⁰ Këto organe luajnë një rol të rëndësishëm në verifikimin e provave që paraqiten nga subjekti si dhe në kryerjen e hetimit përkatës administrativ.

Në pjesën më të madhe të vendimmarrjeve në të cilat KPK ka vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, kriteri i vlerësimit të figurës nuk është analizuar dhe rrjedhimisht nuk ka sjellë shkarkimin e subjektit nga detyra (pasi vendimtar ka qenë kriteri i pasurisë). Vetëm në rastin e subjektit P.M të shkarkuar nga KPK⁴¹, vihet re pasqyrimi i analizës së thellë të këtij kriteri, ku referohet në mënyrë të pjesshme dhe raporti i DSIK-së (pjesërisht i deklasifikuar). Në këtë raport është konstatuar papërshtatshmëria e subjektit për vazhdimin e detyrës. KPK rezulton se ka kryer një hetim të thelluar lidhur me informacionin e pasqyruar në raportin e DSIK-së, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe provueshmërisë e tij. Pas hetimit, trupi gjykues, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit paraqet probleme serioze, pasi ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar⁴². Në këtë vendim dallon analiza që i është kryer këtij kriteri, në dallim nga pjesa tjetër e vendimeve të shkarkimit, ku pjesën dërrmuese të arsyesimit përgjatë tekstit të vendimit, e zë vlerësimi i kriterit të pasurisë.

Ekspertët e KShH-së vërejnë se analiza e kriterit të figurës gjen reflektim më të plotë në tre vendime konfirmimi të KPK dhe një vendim të KPA-së, përkatësisht për subjektet D.B., M.M. dhe A.M (analiza në vijim). Referuar këtyre vendimeve, vërehet se organet e vettingut kanë kryer një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjekteve të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Mgjth, disa elementë të rëndësishëm që kanë rezultuar përgjatë këtij kontrolli nga DSIK, KPK, KPA, duhet të ishin qartësuar qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur në vendim, në funksion të parimit të transparencës dhe besueshmërisë së publikut tek procesi i vettingut. Më konkretisht:

i. Në rastin e subjektit A.M., KPK i ka kërkuar DSIK-së përditësimin e raportit fillestar, duke pasqyruar edhe informacionet e marra rishtazi, të cilat nuk ishin përfshirë në raportin e kontrollit të figurës për këtë subjekt.⁴³ Pas vlerësimit të të dhënave të ardhura pas konstatimit fillestar, DSIK ka konfirmuar konstatimin fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës. KShH konstaton se në vendim nuk referohen të dhënat/indicjet që kanë nxitur KPK-në që të kërkojë përditësimin e raportit fillestar. Në përputhje me nenin 39, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, informacioni pjesë e raportit të grupit të punës nuk bëhet publik

⁴⁰ Neni 36, pika 1 i ligjit nr. 84/2016

⁴¹ Vendimi nr. 202 dt. 06.11.2020

⁴² Vlerësimi i kontrollit të figurës, vendimi nr. 202 dt. 06.11.2020

⁴³ Parag. 37.3 i vendimit nr. 231, dt. 29.01.2020



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

vetëm në rastet kur ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër. Në rastin objekt shqyrtimi, përsa kohë që në vendim nuk citohet ekzistenca e ndalimit ligjor për bërjen publike të tij, kemi mendimin se në funksion të parimit të transparencës ndaj publikut, duhet të evidentoheshin informacionet e marra rishtazi që e bëjnë të domosdoshme përditësimin e raportit konstatues fillestar nga DSIK.

ii. Edhe në vendimmarrjen konfirmuese ndaj subjektit D.B., kemi mendimin se informacioni duhet të ishte më i plotë/qartë lidhur me disa elementë që kanë të bëjnë me kontrollin e figurës së subjektit. Ndaj këtij subjekti, evidentohet se DSIK ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës. Ps realizimit të hetimit të pavarur nga ana e Komisionit, rezulton se nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar të subjektit. Por në vendim argumentohet se, “*në përfundim, DSIK-ja, pavarësisht të dhënave të siguruara nga autoritetet verifikuese, nuk ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimi për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës*”⁴⁴. Shprehja “**pavarësisht të dhënave të siguruara nga autoritetet verifikuese**” nuk është elaboruar dhe qartësuar qoftë në mënyrë të përmbledhur në vendim dhe mund të krijojë paqartësi tek publiku për saktësinë e kontrollit të figurës së subjektit.⁴⁵

iii. Në vendimin e KPA-së lidhur me çështjen e subjektit A.B.⁴⁶, trupi gjykues ka shqyrtuar dhe raportin e depozituar nga DSIK, duke vlerësuar se ai duhet të ishte konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimi me persona të përfshirë në krimin e organizuar. KPA vëren se vendimmarrja e KPK-së lidhur me mënyrën se si është bërë kontrolli i këtij kriteri konstatohet me të meta. Nga ana tjetër, në këtë vendim subjekti ka shfaqur qëndrimin se sekretit shtetëror ka cenuar të drejtën e tij për t’u njohur me aktet që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë proces. Kjo kërkesë e subjektit është rrëzuar si e pabazuar nga ana e KPA-së, duke u mbështetur në kriteret e deklasifikimit dhe përjashtimet nga ky proces të parashikuara në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar. Kjo vendimmarrje është bazuar edhe në standartin e vendosur me praktikën gjyqësore të Dhomës së Madhe të Gjykatës së Strasburgut (GJEDNJ), konkretisht çështja *Regner kundër Çekisë*, 2017 (Dhoma e Madhe). KShH vëren gjithashtu se subjekti i rivlerësimi ka kërkuar të njihet me raportin e parë të depozituar nga ana e DSIK-së, sipas të cilit ai është konsideruar i përshtatshëm për të ushtruar detyrën. Ky raport, i cili konstatohet se është hartuar në referim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016 është rishikuar për shkak se ka pasur mungesë të informacionit nga një prej organeve ligjzbatuese. Nenin 39 i ligjit të vettingut nr. 84/2016 nuk ka realizuar diferencimin e procedurave mes hartimit të një raporti paraprak dhe në vijim të një raporti përfundimtar. Por grupit të punës, në bashkëpunim me DSIK-në i është lënë një afat 60 ditor, me të drejtë shtese 30 ditë, për të verifikuar saktësinë e informacionit. Terminologjia e përdorur nga ligjvënësi “*brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, pas përgatitjes nga grupi i punës të dokumentit/raportit, ia paraqet atë Komisionit*”, nënkupton se kemi të bëjmë me një raport i cili nëse nuk përmban të dhëna të klasifikuara ‘sekret shtetëror’, i vihet në

⁴⁴ Vendim nr. 229, dt. 28.01.2020

⁴⁵ Pika 3 e nenit 38, ligji nr. 84/2016

⁴⁶ Vendim nr. 1, dt. 15.01.2020.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

dispozicion subjektit të rivlerësimit, në funksion të realizimit të barrës së provës dhe mbrojtjes efektive. **Mungesa e informacionit ndaj subjektit, për natyrën e elementëve mbi bazën e të cilëve raporti i DSIK-së pëson ndryshime (shitesa apo reduktime) vlerësojmë se mund të sjellë gjithashtu vështirësi për subjektin, për të ushtruar efektivisht të drejtën e mbrojtjes si dhe ankimit në një instancë më të lartë.**

7. Kriteri i vlerësimit të aftësisë profesionale

Bazuar në Aneksin E të Kushtetutës dhe nenet 40-44 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, organet e vettingut kanë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga KLD (Këshilli i Lartë i Drejtësisë), KLGJ (Këshilli i Lartë Gjyqësor) dhe KLP (Këshilli i Lartë i Prokurorisë), grupi i punës i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës (në rastet e subjekteve që mbajnë statusin e këshilltarit ligjor gjatë procesit të rivlerësimit). Synimi i këtij vlerësimi është identifikimi i subjekteve të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.⁴⁷

Për arsye të ngritjes me vonesë të KLGJ-së dhe KLP-së, gjatë periudhës tranzitore të ngritjes së tyre, organet e vettingut janë bazuar përsa i përket kontrollit të kriterit të vlerësimit të aftësisë profesionale, në relacionet e hartuara nga organet ndihmëse të kohës, KLD dhe Prokuroria e Përgjithshme. Me ngritjen e KLGJ-së dhe KLP-së, **KShH vëren se procedura e ndjekur nga trupat gjyqësore të KPK-së për administrimin e raporteve nga këto organe të reja (pas ngritjes së tyre) nuk ka qenë e njëjtë. Pavarësisht se për të gjitha subjektet presupozohet se KLD dhe Prokuroria e Përgjithshme kanë administruar dhe vendosur në dispozicion të KPK-së relacionet lidhur me kriterin e aftësive profesionale, pas ngritjes së KLP-së dhe KLGJ-së, vërehet se për një pjesë të këtyre subjekteve janë kërkuar relacione të mëtejshme, tashmë nga dy organet e reja ndihmëse (KLGJ/KLP) dhe për një pjesë tjetër, këto relacione nuk janë kërkuar. Konkretisht, procesi i vettingut ndaj subjektit prokuror A.M., ka filluar pas konstituimit të KLP-së (Dhjetor 2018), por ndaj këtij subjekti nuk është administruar relacion nga ana e KLP-së, por vetëm nga grupi i punës i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme.⁴⁸ Ndërkohë në analizën e kriterit të aftësisë profesionale të subjekteve në radhët e gjyqësorit, D.B. dhe M.M., vendimmarrja e KPK-së është bazuar në raportin e hartuar nga KLD dhe nga KLGJ,^{49,50}**

Nga raportet e mëparshme studimore të KShH-së është vënë re, se denoncimet e qytetarëve në përgjithësi nuk kanë patur peshë të rëndësishme në vendimmarrjet e organeve të vettingut. Megjithatë, trendi i kësaj vendimmarrje vërehet se ka ndryshuar me kah më pozitiv, nëse marrim si indikatorë mënyrën se si reflektohen denoncimet e ardhura në vendimet e studiuara, verifikimi që është bërë nga vetë organet e vettingut dhe rezultatet/konkluzionet e dala prej tij. Reflektimi dhe analizimi në vendimmarrjet e organeve

⁴⁷ Parag. 19.1., vendim nr. 21, dt. 13.09.2019, KPA

⁴⁸ Vendim nr. 231, dt. 29.01.2020

⁴⁹ Vendim nr. 229, dt. 28.01.2020, Vendim nr. 234, dt. 04.02.2020

⁵⁰ Vendim nr. 234, dt. 04.02.2020



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

të vettingut, të denoncimeve të ardhura nga qytetarë të ndryshëm, për subjektet në proces rivlerësimi, është tregues i rëndësishëm i besimit të qytetarëve tek ky proces dhe tek drejtësia e re.

Në vendimet e studiuara vërehet se publiku ka luajtur një rol proaktiv nëpërmjet denoncimit të fakteve apo rrethanave të lidhura me subjektet, pranë organeve të vettingut, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016. Është pozitiv fakti se denoncimet anonime janë marrë parasysh në hetimin administrativ kur nga përmbajtja e tyre është mundësuar verifikimi i mëtejshëm i të dhënave apo indicjeve të adresuara. Në rastet e vendimmarrjeve të KPK-së ku është vendosur konfirmimi në detyrë i subjekteve të rivlerësimit, denoncimet e publikut janë reflektuar dhe analizuar. Gjithashtu, është konstatuar realizimi i hetimit të pavarur nga KPK, me qëllim evidentimin e vërtetësisë së këtyre denoncimeve. KShH vlerëson gjithashtu faktin se në vendimmarrjet objekt studimi, në çdo rast është mbrojtur privatësia e qytetarëve që kanë denoncuar në mënyrë jo anonime. Këta qytetarë janë referuar në vendime nëpërmjet inicialeve.

Në disa raste, KPA (Kolegji) ka nënvizuar në vendimmarrjen e tij të metat lidhur me mënyrën se si denoncimet e publikut janë hetuar/vlerësuar nga KPK. Kështu, në rastin e subjektes A.J, ndaj së cilës ishin depozituar 10 denoncime, trupi gjykues arriti në përfundimin se ka zbatuar ligjin brenda kompetencave të saj si drejtuese dhe se mosveprimet e saj të konstatuara në dy raste, nuk mund të përbëjnë shkak për vlerësimin profesional të saj me mangësi apo të papërshtatshëm⁵¹. Në këtë vendimmarrje që konfirmon subjektin në detyrë, nuk rezulton të jetë marrë në konsideratë opinioni i vëzhguesit ndërkombëtarë (i cili në fakt nuk është i detyrueshëm)⁵². Pas dhënies së vendimmarrjes nga KPK, ONM rekomandoi rivlerësimin e subjektit në shkallë të dytë. Lidhur me këtë subjekt, Komisioneri Publik rezulton se ka paraqitur më pas ankim pranë KPA-së.

Krahas denoncimeve të qytetarëve, ekspertët e KShH-së vërejnë se në vendimmarrjet e organeve të vettingut janë marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, edhe fakte të njohura botërisht dhe të publikuara në programe të medias investigative. Për shembull, në rastin e subjektit A.K⁵³, Komisioni ka shqyrtuar 14 denoncime të ardhura nga qytetarët pa e bërë publike përmbajtjen apo trajtimin e tyre dhe është ndalur në disa rrethana dhe dinamika ngjarjesh të publikuara nga një program televiziv investigativ. Subjektit të rivlerësimit, pasi është studiuar përmbajtja e këtij materiali të medias, i është bërë me dije, duke e ftuar, që të jepte shpjegimet e tij. Komisioni, lidhur me çështjen në fjalë dhe me faktet e përshkruara nga subjekti, ka konstatuar shkelje të së drejtës të të pandehurve megjithatë, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë dosjen përkatëse pranë KLGJ-së, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje

⁵¹ Vendimi nr. 221 dt 10.12.2019

⁵² Për njw nga denoncimet e ardhura ndaj kwtij subjekti, vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-sw ka paraqitur opinion me nr. *** prot., datë 14.11.2019, sipas të cilit përfshirja e tre prokurorëve të ndryshëm në fazat fillestare të hetimit, edhe pse bëhet fjalë për muajin gusht, nuk tregon menaxhim të duhur të burimeve të institucionit dhe të sistemit të gatishmërisë, pasi modalitete si ato, të ndodhura në çështjen e sipërpërmendur mund të çojnë, përfundimisht në dëmtim të vetë hetimit.

⁵³ Vendimi nr. 224 dt 20.12.2020



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

disiplinore⁵⁴. Pavarësisht nga shkeljet, KPK ka vlerësuar se problematikat që kanë rezultuar nuk mund të klasifikoheshin si shkelje apo mangësi të rënda profesionale.

Në rastin e subjektit A.M., denoncimi i depozituar një ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore, detyroi trupin gjykues të vendoste riçeljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit. Mgjth, në përfundim, **trupit gjykues i KPK-së vendosi ta cilësonte trajtimin e këtij denoncimi me një peshë më të vogël, duke argumentuar se ka të bëjë me vlerësimin e cilësive drejtuese të subjektit të rivlerësimit dhe jo me aftësitë etiko-profesionale të tij apo integritetin dhe figurën si prokuror.**⁵⁵ Ky konkluzion është i diskutueshëm në vlerësimin tonë, sa kohë KPA ka elaboruar metodologjinë dhe nën-indikatorët e vlerësimit të aftësive profesionale. Në rastin e subjektit të rivlerësimit G.M. (i analizuar në vendimin e KPA-së nr. 21/2019), vlerësimit të aftësive drejtuese i është kushtuar një vëmendje e veçantë, duke u argumentuar se *“vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar me të paktën “shumë mirë” ka përparësi në vlerësimin si magjistrat, i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar”*.

Nëpërmjet vendimit nr. 21/2019, KPA për herë të parë elaboroi standardet dhe metodologjinë e detajuar, lidhur me zbatimin e kriterëve për vlerësimin profesional të subjekteve të rivlerësimit. Në këtë vendimmarrje, KPA ka analizuar një sërë nën-indikatorësh, mbi bazën e të cilëve do të duhet të realizohet vlerësimi i aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, praktikë kjo që duhet të ndiqet jo vetëm nga kolegjet e tjera të KPA por edhe nga KPK. Arrijmë në këtë përfundim pasi KPA, ka argumentuar në këtë vendimmarrje se *‘Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se me qëllimin për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni, **kur është e mundur dhe e nevojshme**, duhet të administrojë të gjitha burimet dhe të vlerësojë të gjitha kriteret, bazuar në treguesit e përcaktuar në nenet 71, 72, 74, 75, 76 të Ligjit 96/2016, dhe njëkohësisht duhet të tregojë mënyrën se si janë administruar burimet dhe janë vlerësuar kriteret, bazuar në treguesit përkatës në analogji me vlerësimin e aftësive profesionale të realizuar për subjektin e rivlerësimit në vendimin 21/2019, sipas arsytimit të mësipërm’* (para. 26).

Denoncimi i qytetarit, i cili ka shërbyer si një element nxitës në mënyrë që KPK të riçelte hetimin administrativ, ka qenë objekt i analizës së anëtares së trupit gjykues të këtij organi, e cila ka shprehur mendimin e saj në pakicë.⁵⁶ Sipas këtij mendimi, evidentohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm moskryerjen e disa veprimeve procedurale, mosnjohimin e palëve në proces, mangësinë në kryerjen e hetimeve, mosnjohimin e palëve për shtyrjen e afateve, mosshortimin e një çështjeje në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, etj., elementë që krijojnë premisa për cënimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Bazuar në metodologjinë e elaboruar në vendimin e KPA-së nr. 21/2019, ekspertët e KShH-së vërejnë se elementët e cilësuar në mendimin e anëtares në pakicë, përfshihen në gamën e aftësive organizative. Kriteret e përgjithshme të elaboruara në këtë metodologji, nuk rezultojnë të jenë më pak apo më shumë në prevalencë me njëra-tjetrën, dhe shqyrtimi i tyre nuk reflektohet që duhet realizuar në mënyrë alternative. Metodologjia e shtjelluar nga KPA, kërkon që se pas elaborimit tërësor të kriterëve të përgjithshme dhe nën-kriterëve

⁵⁴ Paragrafi 17, Vendimi nr. 224 dt 20.12.2020

⁵⁵ Parag. 49.20, vendim nr. 231, dt. 29.01.2020

⁵⁶ Mendim pakice. Link: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/03/Mendim-Pakice-A.Martini.pdf>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

shtesë të tyre, të bëhet vlerësimi i aftësive profesionale e subjektit të rivlerësimit, duke vënë në pah dhe parregullsitë e mangësitë e konstatuara.

Ekspertët e KShH-së nënvizojnë se vetëm në raste të caktuara të vendimmarrjes së KPK-së, janë elaboruar të gjitha nën-indikatorët, në kuadër të realizimit të vlerësimit profesional, si për shembull, në rastin e subjektit të rivlerësimit V.M. Por, krahas këtij vendimi, vlen për tu nënvizuar si një konstatim i përgjithshëm se vendimet e KPK, diktojnë nevojën për të pasqyruar në mënyrë më të unifikuar dhe të plotë, ndjekjen dhe vënien në zbatim të metodologjisë (dhe indikatorëve të saj) për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, të elaboruar në vendimin nr.21/2019 të Kolegjit (KPA-së). Për shembull në vendimin nr. 218 datë 10.12.2019 të KPK, vihet re se ndërsa Komisioni është ndalur gjerësisht në analizën e kontrollit të pasurisë të subjektit K.K, kriteri i vlerësimit profesional është analizuar në vija të përgjithshme.

8. Cilësia e vendimmarrjes, mendimet në pakicë apo paralele

Në lidhje me strukturën e vendimeve, krahasimisht vendimet e KPA vijnë të paraqesin një standart më të mirë sa i takon përmbledhjes së fakteve, evidentimit në mënyrë të strukturuar për secilin kriter të shkaqeve të ankimit, evidentimit të pretendimeve të subjektit dhe Komisionerit, provave të siguruara prej tyre, provave të siguruara nga hetimi administrativ nëse ky është kryer nga KPA, analizës kushtetuese-ligjore, dhënies së vlerësimit nga vetë trupa e KPA-së për secilin shkak ankimor dhe pretendim të palëve. Gjithashtu, në disa nga vendimet e KPA-së është vërejtur referim edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Nga vendimet e publikuara të KPK dhe KPA rezulton se shumica e tyre janë të gjata dhe mjaft voluminoze, dhe në disa raste vërehen përsëritje të fakteve / analizës përgjatë përmbajtjes së vendimit. Megjithatë, volumi i vendimeve, me përjashtim të rasteve kur mund të krijohen përsëritje të panevojshme, kontribuon në drejtim të transparencës së procesit ndaj publikut dhe ekspertëve që studiojnë këto vendimmarrje, të cilët e kanë të pamundur të njihen plotësisht me ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit, bazuar vetëm në zhvillimet e seancës dëgjimore publike.

Vlerësimi i kriterit të pasurisë zë peshën kryesore në përmbajtjen e vendimit si dhe në arsyetimin për vendimmarrje.

Në plotësim të kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 55 pika 5 të ligjit nr. 84/2016, si në vendimmarrjet e KPK-së dhe ato të KPA-së, mendimi në pakicë apo paralel i gjyqtarëve është publikuar në mënyrë të argumentuar, në kampionin e vendimeve objekt studimi.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Aneks 1

Lista e vendimeve objekt studimi në KPK

Subjekti	Data Vendimit
Ilijana Olldashi	Nr.215 dt. 04.12.2019
Klodian Kurushi	Nr. 218 dt. 10.12.2019
Anita Jella	Nr.221 dt. 10.12.2019
Doloreza Musabelliu	Nr. 217 dt. 05.12.2019
Fatri Islamaj	Nr.220 dt. 10.12.2019
Marjana Velcani	Nr. 222 dt. 12.12.2019
Genti Xholi	Nr. 219 dt. 10.12.2019
Arjan Balliu	Nr 211 dt.18.11.2019
Astrit Kalaja	Nr. 224 dt. 20.12.2019
Përparim Kulluri	Nr.202 dt. 06.11.2019
Sulejman Kurti	Nr. 203 dt. 08.11.2019
Daniela Shirka	Nr. 208 dt.08.11.2019
Kleanth Zeka	Nr.212 dt. 22.11.2019
Ndini Tavani	Nr. 199 dt.11.10.2019
Brunilda Malo	Nr.206 dt. 07.11.2019
Simon Pashuku	Nr. 213 dt. 22.11.2019
Isuf Shehu	Nr. 210 dt. 14.11.2019
Arben Vrioni	Nr. 214 dt. 22.11.2019
Stavri Kallco	Nr. 235, dt. 04.02.2020
Liljana Sulollari (Baku)	Nr. 232, dt. 31.01.2020
Ketra Bajrami	Nr. 226, dt. 14.01.2020
Marina Rraboshta	Nr. 236, dt. 06.02.2020
Tomor Skreli	Nr. 240, dt. 24.02.2020
Dritan Banushi	Nr. 229, dt. 28.01.2020
Miliana Muca	Nr. 234, dt. 04.02.2020
Adnand Xhelili	Nr. 237, dt. 12.02.2020
Osman Aliu	Nr. 246, dt. 05.03.2020
Elona Kana	Nr. 233, dt. 03.02.2020
Marsela Balili	Nr. 228, dt. 17.01.2020
Erion Pustina	Nr. 250, dt. 09.03.2020
Agim Dilka	Nr. 252, dt. 11.03.2020
Anton Martini	Nr. 231, dt. 29.01.2020
Astrit Haxhialushi	Nr. 225, dt. 07.01.2020
Joana Qeleshi	Nr. 204, dt. 06.11.2019
Njazi Seferi	Nr. 205, dt. 06.11.2019
Agim Bendo	Nr. 216, dt. 04.12.2019



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Lista e vendimeve të studiuara të KPA

Subjekti	Data e vendimit
Besnik Muci	Nr.32 datë 21.11.2019
Artor Ylli	Nr.31 datë 20.11.2019
Ahmet Jangulli	Nr.30 datë 18.11.2019
Fatos Qato	Nr.29 datë 08.11.2019
Admir Belishta	Nr. 1, dt. 15.01.2020
Arben Dollapaj	Nr. 04, dt. 12.03.2020 (vendim i përmbledhur)
Entela Prifti	Nr. 34 (JR), dt. 02.12.2019
Adnan Kosova	Nr. 5 (JR) dt. 13.03.2020 (vendim i përmbledhur)